



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 129 , datë 21.09.2019

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE TË LEJUAR
PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT TË KRIJUAR NË GJYKATËN
KUSHTETUESE, VAKANCË E PLOTË, TË SHPALLUR NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000 dhe të pikës 5 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si edhe të pikave 71 dhe 72 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit për Renditjen e Kandidatëve të Lejuar për Plotësimin e Vendit Vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, Vakancë e Plotë, të Shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI

ARDIAN DVORANI

